

MB CONSULTING SH.P.K.

Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Bilanci Kontabel

për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017
(vlerat në Lek)

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktivët			
Aktivët afatshkurtra			
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	4	9,105,609	3,421,149
Llogari të arketueshme	5	7,898,733	5,501,644
Llogari të tjera të arketueshme	6	10,483,218	8,757,251
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	7	49,000	49,000
Totali i aktiveve afatshkurtra		27,536,559	17,729,044
Aktivët afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	1,179,028	1,075,147
Totali i aktiveve afatgjata		1,179,028	1,075,147
Totali i aktiveve		28,715,588	18,804,191
Detyrimet dhe kapitali			
Detyrimet afatshkurtra			
Te pagueshme ndaj furnitoreve	9	697,536	294,927
Detyrime të tjera afatshkurtra	10	665,916	144,092
Detyrime tatimore	11	970,467	528,813
Totali i detyrimeve afatshkurtra		2,333,919	967,832
Totali i detyrimeve		2,333,919	967,832
Kapitali			
Kapitali aksioner	12	100,000	100,000
Fitimet (humbjet) e akumuluar		17,733,358	10,408,117
Fitimi (humbja) e vitit		8,548,310	7,325,242
Totali i kapitalit		26,381,669	17,836,358
Totali i detyrimeve dhe kapitalit (I,II,III)		28,715,588	18,804,191

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(bazuar në klasifikimin e shpenzimeve sipas natyrës)

(vlerat në Lek)

	Notes	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2016
Shitjet neto	13	25,960,509	18,861,811
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit		-	-
Te ardhurat totale		25,960,509	18,861,811
Materialet e konsumuara		-	-
Kosto e punës	14	(10,874,253)	(7,139,212)
Amortizimet	8	(227,640)	(273,389)
Shpenzime të tjera	15	(4,436,201)	(2,550,275)
Totali i shpenzimeve		(15,538,094)	(9,962,876)
Fitimi (humbja) nga veprimtaria kryesore		10,422,415	8,898,934
Të ardhurat (shpenzime) financiare			
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi		(364,371)	(279,228)
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare		-	-
Totali te ardhura (shpenzime) financiare		(364,371)	(279,228)
Fitimi (humbja) para tatimit		10,058,043	8,619,706
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin (@15%)	16	(1,509,733)	(1,294,464)
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar		8,548,310	7,325,242
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse per vitin		-	-
Totali I te ardhurave gjithëpërfshirëse per vitin		-	7,325,242

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(vlerat në Lek)

	Kapitali aksioner	Fitimi i Pashperndare	Totali
Pozicioni më 1 janar 2016	-	10,408,117	10,408,117
Emetim i kapitalit aksioner	100,000	-	100,000
Fitimi (humbja) e vitit	-	7,325,242	7,325,242
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	100,000	17,733,358	17,833,358
Emetim i kapitalit aksioner	-	17,733,358	17,733,358
Fitimi (humbja) e vitit	-	8,548,310	8,548,310
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	100,000	26,281,669	26,381,669

Pasqyra e flukseve të parasë
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017
(vlerat në Lek)

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit		
Fitimi pas tatimit (humbja)	8,548,310	7,328,242
Rregullime për:		
Amortizim dhe zhvleresim	227,640	273,389
Shpenzimet e tatim fitimit	(1,509,733)	1,291,464
Të ardhura nga interesat		
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues	7,266,217	8,893,095
Rritje/zvogëlim në tepricën e kërkesave të arkëtueshme	(4,102,272)	(5,182,396)
Rritje/zvogëlim në tepricën e detyrimeve për t'u paguar	3,789,740	(286,809)
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit	6,953,686	3,423,890
Tatim fitimi i paguar	(937,704)	(1,368,303)
Fluksi neto monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit	6,015,982	2,055,587
Fluksi monetar nga veprimtaritë e investimit		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(331,521)	(31,249)
Të ardhura nga shitja e pajisjeve	-	-
Dividendët e arkëtuar	-	-
Interesa të arkëtuar	-	-
Fluksi neto monetar nga veprimtaritë e investimit	(331,521)	(31,249)
Fluksi monetar nga veprimtaritë e financimit		
Hyrje nga emetimi i kapitalit aksioner	-	-
Hyrje nga huatë	-	-
Pagesat e huave	-	-
Dividendët e paguar	-	-
Fluksi neto monetar nga veprimtaritë e financimit	-	-
Rritja/(zvogëlimi) neto i mjeteve monetare	5,684,460	2,024,338
Mjetet monetare në fillim të periudhës	4 3,421,149	1,396,810
Mjetet monetare në fund të periudhës	4 9,105,609	3,421,149

MB CONSULTING SHPK

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Shoqeria MB CONSULTING Sh.p.k. eshte rregjistruar prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne daten 28/02/2012 me NUIS L21428011V, bazuar ne Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare". Kapitali i nenshkruar i shoqerise eshte 100 000 Leke.

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj Sherbimet ne fushen e kontabilitetit, keshillime fiskale, keshillime financiare, sherbime te tjera keshillimi, assistance per themelimin dhe drejtimin e shoqerive, kryerjen e vleresimeve, sherbime te trajnimit profesional, sherbime te ndryshme ndermjetesimi dhe cdo lloj veprimtarie te ligjshme qe konsiderohet fitimprurese per shoqerine. Kryerjen e sherbimeve sipas marreveshieve te rena dakort me klientet..

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Njesia bashkiake nr 5, rruga Brigada VIII, pallati 16, kati 5, ap 29, Tirane.

2. BAZAT E PERGATITJES

2.1 Pajtueshmeria

Pasqyrat Financiare jane pergatitur ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SKK).

Bazuar ne SKK 11 "Tatimi mbi Fitimin", paragrafi 4, Shoqeria ka zgjedhur te mos kontabilizojë tatimet e shtyra ne pasqyrat financiare per vitin qe mbyllet me 31 dhjetor.

2.2 Bazat e Matjes

Pasqyrat Financiare jane pergatitur duke u bazuar ne koston historike, perjashtuar derivativet financiare (n.q.s ka), instrumentat financiare me vlere te drejte permes fitimit e humbjes dhe aktivet financiare te vlefshme per shitje, te cilat maten me vlere te drejte.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat Financiare jane pasqyruar ne Leke e cila eshte monedha funksionale e kompanise. Shifrat jane te rumbullakosura ne Leke.

2.4 Perdorimi i gjykimeve dhe vleresimeve

Paraqitja e Pasqyrave Financiare konform SKK-ve, kerkon qe manaxhimi te beje vleresime, gjykime e supozime qe ndikojne ne aplikimin e politikave kontabel dhe vleren e raportuar te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave e shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime.

Vleresimet dhe supozimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vleresimeve kontabel njihen ne periudhen kur ndodh rishikimi si dhe ne cdo periudhe te ardhme qe preket.

2.5 Periudhat krahasuese

Te dhenat e periudhave te meparshme mund te riklasifikohen per t'i bere ato te krahasueshme me paraqitjen e te dhenave te periudhes ushtrimore.

3. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL

Politikat kontabel ne vijim jane aplikuar ne menyre te qendrueshme ne te gjitha periudhat e paraqitura ne pasqyrat financiare, me perjashtim te rasteve kur specifikohet ndryshe nese ka te tilla.

(a) Transaksionet ne monedha te huaja

Transaksionet ne monedhe te huaj rregjistrohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Mjetet monetare ne monedhe te huaj rivleresohen ne fund te çdo periudhe raportuese me kursin zyrtar te kembimit ne daten e raportimit.

Mjetet jo-monetare ne monedhe te huaj rregjistrohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit, ndersa mjetet jo-monetare qe maten me vlere te drejte rivleresohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten kur percaktohet vlere e drejte.

Fitimi ose humbja qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit te perdorura per konvertim ne 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 jane si me poshte:

	2017	2016
EURO	132.95	135.23

(b) Instrumentat financiare

Instrumentat financiare jo-derivative perbehen nga llogari te arketueshme, mjete monetare, hua te marra dhe te dhena dhe llogari te pagueshme. Instrumentat financiare jo-derivative njihen fillimisht me vleren e drejte plus çdo kosto transaksioni qe lidhet me to, perveç siç pershkruhet me poshte. Per instrumentat e mbajtur me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, koston e transaksionit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Ne vijim te njohjes fillestare instrumentat financiare jo-derivative maten siç pershkruhet me poshte. Nje instrument financiar njihet nese Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te shoqerise mbi flukset e parase se aktivitet financiar ose kur shoqeria transferon aktivitet financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen shoqeria angazhohet te bleje apo te shese aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe te tjera ekuivalente

Mjetet monetare perfshijne arken, llogarite rrjedhese, si dhe depozitat afatshkurtra me nje maturitet deri ne tre muaj.

Llogarite e arketueshme

Llogarite e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjet nga zhvleresimi. Provigjioni per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues qe llogarite e arketueshme te zhvleresohen.

Shuma e provigjionit llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Llogarite e pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe ne vijim maten me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Huamarrjet dhe parapagimet

Huate e marra nga Institucionet Financiare njihen fillimisht me vleren e drejte, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten me pas me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazen e interest efektiv.

Metoda e normes efektive te interesit eshte nje metode per llogaritjen e koston se amortizuar te nje detyrimi financiar dhe per alokimin e shpenzimeve te interesit pergjate periudhes. Norma efektive e interesit eshte norma e cila skonton ekzaktesisht pagesat e ardhshme te vleresuara pergjate jetes se pritshme te detyrimi financiar, ose, ku eshte e pershtatshme, per nje periudhe me te shkurter.

Te tjera

Instrumenta te tjera financiare jo derivative jane matur me koston e amortizueshme, duke perdorur metodën e normës së interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimet.

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme jane klasifikuar si kapital.

(c) Aktivët afatgjatë materiale

i. Njohja dhe matja

Aktivët afatgjatë materiale maten me kosto, duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluaranga zhvlerësimi.

Kostoja përfshin shpenzimet të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e montimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e meparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të bera gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë perkatese të aktivit kur perfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi perkates sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetegjatesi të ndryshme, ato regjistrohen si zera të ndryshme të ndara nga njëra tjetra.

Fitimet ose humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjatë materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurën nga shitja me vlerën kontabel neto të aktivit afatgjatë material mbetur dhe

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjatë materiale njihet në vlerën kontabel të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare apo zbritëse të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira financiare amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka dhe aktivët në proces nuk amortizohen.

Metodat dhe normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe të meparshme janë si më poshtë:

Ndertesa	5% (mbi vlerën e mbetur)
Makineri pajisje	20% (mbi vlerën e mbetur)
Mjete transporti	20% (mbi vlerën e mbetur)
Pajisje kompjuterike	25% (mbi vlerën e mbetur)
Pajisje zyre dhe të tjera	20% (mbi vlerën e mbetur)

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

(d) Inventaret

Inventaret maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Pas njohjes fillestare inventaret vlerësohen me vlerën më të vogël ndërmjet koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarit përcaktohet sipas metodës së mesatares së ponderuar. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes i vlerësuar në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuara të nevojshme për të kryer shitjen, sipas metodës së koston mesatare të ponderuar.

(e) Zhvleresimi

i. Aktivet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi dhe të cilat mund të maten me besueshmëri. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të aktualizuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale, ndërsa aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Aktivet jofinanciare

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare të shoqërisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë që ka pësuar rënie në vlerë. Nëse ka të dhëna të tilla, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(f) Perfitimet e punonjesve

Gjatë ecurisë normale të aktivitetit të saj, shoqëria paguan kontributet shoqërore dhe shëndetësore në emër të vet dhe të punonjesve të saj, të cilat janë të detyrueshme sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin e ndodhjes.

(g) Provigjonet

Një provigjon njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të nevojiten flukse dalëse të burimeve ekonomike për të shlyer këto detyrime. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

(h) Njohja e të ardhurave

Te ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që shoqëria do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, për shlyerje të menjëhershme etj.

Te ardhurat dhe shpenzimet njihen në pasqyrat financiare të periudhës të ciles i perkasin. Në lidhje me shitjen e mallrave, te ardhurat njihen kur ndryshimi i pronësive se bashku me rrezikun që vjen nga ky ndryshim, janë transferuar tek blerësi. Te ardhurat nga shërbimet njihen kur shërbimi është kryer, në varesi të fazës së perfundimit të transaksionit në datën e raportimit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostovet perkatëse.

(i) Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare përfshijnë te ardhurat nga interesat për llogaritë bankare, dhe përfitimet nga diferencat e kembimit. Interesat njihen ashtu siç përlogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesa dhe humbjet nga luhatjet e kurseve të kembimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nepërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga kurset e kembimit raportohen në baza neto.

(j) Tatimi mbi fitimin


Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin tatimin e periudhes, i cili njihet drejtperdrejt ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhes eshte tatimi i pritshem per t'u paguar mbi te ardhurat e tatueshme te vitit, duke perdorur normat tatimore te miratuara ne periudhen e raportimit.

(k) Ngjarjet pas datës së bilancit

Ngjarjet pas datës së raportimit, të cilat ofrojnë dëshmi për kushtet që ekzistojne në datën e raportimit, trajtohen si ngjarje të korrigjueshme në këto pasqyra financiare. Ata që janë tregues të kushteve që lindin pas datës së raportimit janë trajtuar si ngjarje të pakorrigjueshme.

Keto pasqyra financiare jane pergatitur dhe aprovuar per perdorim nga:

Miratoi:



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'BUDAN WANA', is written over a horizontal line.



4. Mjetet monetare

Shoqëria ka llogari bankare në Leke dhe në monedhe të huaj. Gjendja e mjeteve monetare në arke dhe banke në fund të vitit ushtrimor përbehet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Llogari rrjedhese	9,052,304	3,312,505
- në Leke	196,082	152,756
- në monedhe të huaj	8,856,222	3,159,749
Arka	53,305	108,643
- në Leke	13,420	27,137
- në monedhe të huaj	39,885	81,506
TOTAL	9,105,609	3,421,149

5. Llogari të arketueshme

Llogaritë e arketueshme më 31.12.2017 dhe 31.12.2016 përbehen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Llogari të arketueshme nga kliente	7,898,733	5,501,644
TOTAL	7,898,733	3,076,499

6. Llogari të tjera të arketueshme

Llogaritë e tjera të arketueshme përbehen nga të drejta të tjera për të arketuar nga të treta si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Huadhenie afatshkurter	10,237,150	8,654,001
Tatim Fitimi	-	56,055
Tatim fitimi I thjeshtuar	20,784	20,784
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	151,484	
Llogari në pritje	73,800	26,412
TOTAL	10,483,218	6,000,000

7. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra përbehen prej pagesave të cilat I janë kryer paleve të treta si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Parapagima afatshkurtra	49,000	49,000
TOTAL	49,000	49,000

8. Aktive afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale perbehen si me poshte:

	Ndertime & permiresime	Mobilje & Pajisje Zyre	Pajisje Informatike	Te tjera	Totali
Kosto					
Gjendje me 01.01.2016	112,500.00	1,080,486	544,948	-	1,737,934
Shtesa	-	22,083	9,167	-	31,250
Pakesime					-
Gjendje me 31.12.2016	112,500	1,102,569	554,115	-	1,769,184
Shtesa	-	331,521			331,521
Pakesime					-
Gjendje me 31.12.2017	112,500	1,434,090	554,115	-	2,100,705
Amortizimi I akumuluar					
Gjendje me 01.01.2016	5,625	281,606	133,416	-	420,647
Amortizimi i vitit	5,344	163,827	104,220		273,390
Pakesime					-
Gjendje me 31.12.2016	10,969	445,433	237,636	-	694,037
Amortizimi i vitit	5,077	143,443	79,120		227,640
Pakesime					-
Gjendje me 31.12.2017	16,045	588,876	316,755	-	921,677
Vlera e mbetur neto					
Gjendja me 31.12.2016	101,531	657,137	316,479	-	1,075,147
Gjendja me 31.12.2017	96,455	845,214	237,359	-	1,179,028

9. Llogari te pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Te pagueshme ndaj furnitoreve per sherbime	697,536	294,927
TOTAL	697,536	270,550

10. Detyrime te tjera afatshkurtra

Ne kete ze jane perfshire detyrime te tjera afatshkurtra, te cilat priten te mbyllen gjate vitit 2018.

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Detyrime per pagat	352,089	49,431
Detyrime per qirane	93,065	94,661
Parapagime te mara	220,762	
TOTAL	665,916	270,550

11. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore jane llogaritur duke mbajtur parasysh kerkesat e legjislacionit perkates. Detyrimet tatimore ne daten e raportimit perbehen nga:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Tatim Fitimi	525,814	
Sigurime shoqerore dhe shendetesore dhe TAP	350,254	256,916
TVSH		263,250
Tatimi ne burim	94,399	8,647
TOTAL	970,467	1,020,987

12. Kapitali

Kapitali i shoqerise perbehet nga kuotat e kapitalit, te cilat jane njohur me vleren nominale. Kapitali i shoqerise ka vleren nominale prej 100000 Leke.

13. Te ardhurat

Ne kete ze jane paraqiten te ardhurat e realizuara nga shoqeria gjate rrjedhes se aktivitetit nga sherbimet.

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Te ardhura nga sherbimet	25,960,509	18,861,811
TOTAL	25,960,509	15,559,592

14. Kosto e punes

Kosto e punes perbehen nga pagat bruto te punonjesve dhe kostot e sigurimeve shoqerore qe paguan shoqeria si me poshte:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Pagat	9,484,470	6,221,842
Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	1,389,783	907,315
TOTAL	10,874,253	7,129,157

15. Shpenzime te tjera

Shpenzimet e tjera perbehen si me poshte:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Nenkontraktme per sherbime IT	1,345,926	
Konsulence juridike	344,515	1,034,102
Qira	1,263,485	691,757
Transferime, udhetime, dieta	473,024	72,975
Shpenzime postare, telefon dhe internet	98,427	14,788
Shpenzime energji elektrike, uji	149,111	119,868
Anëtarësime dhe abonime	100,000	120,555
Te tjera	661,713	496,231

TOTAL	4,436,201	2,550,275
--------------	------------------	------------------

16. Shpenzimi i Tatim Fitimit

Me poshte do te gjeni te permbledhur informacionin ne lidhje me tatimin

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Fitimi neto per vitin e ushtrimit	10,058,043	8,619,706
Shpenzime te pazbritshme	6,840	10,055
Fitimi i tatueshem neto per vitin	10,064,883	8,609,651
Shpenzimi i tatim fitimit 15%	1,509,733	(1,294,464)
Parapagime gjate vitit	937,704	1,368,303
Parapagime te viteve te shkuara	46,215	
Shpenzimi i tatim fitimit per tu paguar	525,814	

17. Palet e lidhura

Një numër transaksionesh mund te kryhen me palët e lidhura në rrjedhën normale të biznesit. Këto transaksione janë kryer në terma tregtare dhe në normat e tregut.

18. Ngjarje pas dates se bilancit

Ngjarje te ndodhura pas dates se bilancit per te cilat behen rregullime apo ngjarje te ndodhura pas dates se bilancit per te cilat nuk behen rregullime nuk ka.

Per Drejtimin e Njesise Ekonomike

[Signature]



Aktivet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2017

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01-01-17	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31-12-17
1	Ndertime		112,500			112,500
2	Mobilje dhe orendi		1,102,569	331,521		1,434,090
3	Pajisje informatike		554,115	-		554,115
4	Te tjera		-	-		-
	TOTALI		1,769,184	331,521	-	2,100,705


Amortizimi A.A.Materiale 2017

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01-01-17	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31-12-17
1	Ndertime		10,969	5,077		16,045
2	Mobilje dhe orendi		445,433	143,443		588,876
3	Pajisje informatike		237,636	79,120		316,755
4	Te tjera		-	-		-
	TOTALI		694,037	227,640	-	921,677

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2017

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01-01-17	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31-12-17
1	Ndertime		101,531	-	5,077	96,455
2	Mobilje dhe orendi		657,137	331,521	143,443	845,214
3	Pajisje informatike		316,479	-	79,120	237,359
4	Te tjera		-	-	-	-
	TOTALI		1,075,147	331,521	227,640	1,179,028

Administratori

Bledion Miftari




INVENTARI ANALITIK

31.12.2017

Nr.	Artikulli	Nj / M	Sasia	Kosto	Vlera
1	NUK KA				
2					
3					
4					
5					
	Shuma				-

Per Drejtimin e Shoqerise



Inventari automjeteve ne pronesi te subjekt 2017

Nr	Lloji automjetit	Kapaciteti	Targa	Vlera	Data e Blerjes	Marka
1	NUK KA					
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
14						
15						
16						
17						
18						
19						
20						
Shuma						

Per Drejtimin e Shoqerise

BLEDAN MANU
